

RREGULLAT E PROMOCIONIT "Samsung Lifestyle"

Data e publikimit dhe e hyrjes në fuqi të këtyre rregullave: 22.09.2022.

Përpara se të blini një nga televizorët Samsung "The Frame" dhe Samsung "The Serif", ju lutem lexoni rregullat e këtij Promocioni (në vijim referuar si "**Rregullat**"):

1. Organizatori i Promocionit

Samsung Electronics Austria GmbH, me seli në Vjenë në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri dhe regjistruar me numër regjistrimi FN 217924b (në vijim referuar si "**Samsung**"), organizon promocionin e televizorëve Samsung "The Frame" dhe Samsung "The Serif" të modeleve: 50" The Frame TV (2022); 55" The Frame TV (2022); 65" The Frame TV (2022); 75" The Frame TV (2022); 50" The Serif TV; 55" The Serif TV; 65" The Serif TV (në vijim veçmas "**Pajisja**" ose bashkërisht "**Pajisjet**").

2. Periudha e promocionit dhe pjesëmarrësit

Promocioni vlen për blerësit privatë dhe biznes në territorin e Republikës së Shqipërisë që plotësojnë kushtet e përcaktuara në këto Rregulla.

Kohëzgjatja e promocionit ("**Periudha e Promocionit**") për Pajisjet është nga data 22.09.2022 deri në 23.10.2022.

3. Përfitimet nga Promocioni

Blerësit privatë dhe biznes të cilët, gjatë Periudhës së Promocionit, blejnë pranë njërit prej partnerëve të shitjes së Samsung të listuar në këto Rregulla, njërin nga televizorët Samsung të renditur në tabelën e mëposhtme, do të kenë të drejtën të fitojnë si dhuratë një nga pajisjet e renditura në tabelën më poshtë (në vijim "**Dhurata**").

Modeli	Kodi i Modelit	Dhurata	Kodi i Modelit të Dhuratës
50" The Frame TV (2022)	QE50LS03BAUXXH	Jet60	VS15A6031R1/GE
55" The Frame TV (2022)	QE55LS03BAUXXH	Jet60	VS15A6031R1/GE
65" The Frame TV (2022)	QE65LS03BAUXXH	Jet70	VS15T7036R5/GE
75" The Frame TV (2022)	QE75LS03BAUXXH	Jet70	VS15T7036R5/GE
50" The Serif TV	QE50LS01BAUXXH	Jet60	VS15A6031R1/GE
55" The Serif TV	QE55LS01BAUXXH	Jet60	VS15A6031R1/GE
65" The Serif TV	QE65LS01BAUXXH	Jet70	VS15T7036R5/GE

4. Kushtet për përfitim të drejtave nga Promocioni

Është i mundur fitimi i Dhuratës nga blerësit e Pajisjeve, me kusht përmbushjen në mënyrë kumulative të kushteve vijuese:

- Blerësi blen Pajisjen gjatë Periudhës së Promocionit përcaktuar në pikën 2 të këtyre Rregullave;
- Pajisja blihet pranë partnerit të autorizuar të shitjeve të Samsung në territorin e Republikës së Shqipërisë; Lista e partnerëve të autorizuar përcaktohet në pikën 7 të kësaj Rregulloreje;
- Blerësi blen Pajisjen si përdorues fundor; Përdoruesit fundorë janë personat fizik ose juridik në territorin e Republikës së Shqipërisë të cilët kanë blerë pajisjen për qëllimet e tyre vetjake dhe jo me qëllim shitjen apo shpërndarjen e mëtejshme;
- Pajisjen e blerë, blerësi e regjistron duke dërguar një e-mail në adresën ce.promotion@samsung.com, me informacionin e përshkruar në pikën 5 të këtyre Rregullave, jo më vonë se 20 ditë nga dita e blerjes së Pajisjes.

5. Regjistrimi i Pajisjes

Parakushti për marrjen e Dhuratës është regjistrimi i Pajisjes së blerë gjatë Periudhës së Promocionit. Regjistrimi duhet kryer duke dërguar një e-mail në adresën ce.promotion@samsung.com, jo më vonë se 20 ditë nga dita e blerjes së Pajisjes.

Procesi i regjistrimit përfshin vendosjen e të dhënave të nevojshme për regjistrimin e suksesshëm. Të dhënat që duhet të vendosen në e-mail, me qëllim që blerësi të ketë të drejtën të përfitojë Dhuratën, dhe me qëllim dërgimin e Dhuratës pas regjistrimit të suksesshëm janë:

- Emri dhe mbiemri i blerësit të Pajisjes ose emri i shoqërisë,
- Adresa e e-mailit e blerësit të Pajisjes,
- Numri i kontaktit i blerësit,
- Adresa e banimit / adresa e selisë së blerësit të Pajisjes në territorin e Republikës së Shqipërisë (me qëllim dërgimin e Dhuratës),
- Numri serial i Pajisjes së blerë,
- Paraqitje / skanim i faturës tatimore për pajisjen e blerë.

Duke dërguar e-mailin si më sipër, blerësi i dërgon të dhënat Samsung dhe nënkontraktuesve të tij me qëllim verifikimin e plotësisht të kushteve, pra nëse blerësi ka fituar të drejtën për të marrë Dhuratën, dhe blerësit jep gjithashtu pëlqimin e shprehur për përdorimin e të dhënave të tij personale në përputhje me parashikimet e këtyre Rregullave. Pëlqimi i blerësit është i domosdoshëm që procesi i regjistrimit të konsiderohet i suksesshëm.

6. Dorëzimi i Dhuratës

Dorëzimi i Dhuratave, me kusht që të jetë kryer me sukses regjistrimi sipas kësaj Rregulloreje, do të kryhet brenda 90 ditëve nga data e regjistrimit të Pajisjes, në adresën e vendosur në e-mailin e regjistrimit, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Dhuratat do të dorëzohen me shpenzimet e Organizatorit.

7. Partnerët e Autorizuar të shitjeve Samsung

- Neptun Sh.p.k
- Globe Shops Sh.p.k

8. E drejta e ndryshimit të kushteve të promocionit

Samsung rezervon të drejtën të ndryshojë këto Rregulla në çdo kohë, për arsye të justifikuara, me detyrimin që t'i publikojë pa vonesë.

NJOFTIMI PËR MBLEDHJEN DHE PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Procedura e aplikimit për të përfituar të drejtën për dhuratë në kuadër të këtij promovimi përfshin dhënien e të dhënave personale të përdoruesit të nevojshme për një aplikim të suksesshëm.

Të dhënat të cilat do të mbledhen për qëllimet e mësipërme janë vijueset:

- Emri dhe mbiemri i përdoruesit,
- Adresa e e-mailit të përdoruesit,
- Numri i kontaktit të përdoruesit,
- Adresa e saktë e vendbanimit të përdoruesit (për dorëzimin e dhuratës),
- Numri serial i Pajisjes së blerë,
- Paraqitje / skanim i faturës tatimore për Pajisjen e blerë.

Të dhënat personale të përdoruesve do të mbledhen dhe përpunohen në përputhje me rregullat e privatësisë dhe të mbrojtjes së të dhënave personale të Samsung, të cilat janë renditur më poshtë në këtë njoftim e në përputhje me këto Rregulla, si dhe në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Qëllimi i mbledhjes së të dhënave personale të përdoruesit është verifikimi i plotësisë të kushteve për të përfituar të drejtën për dhuratë dhe përcaktimin e adresës së përdoruesit për dorëzimin e dhuratës.

Duke vendosur të dhënat e veta personale në mënyrën e kërkuar e në përputhje me Rregullat e promovimit, përdoruesi (pjesëmarrës në promovimin përkatës) konfirmon se është në dijeni se shoqëria Samsung Electronics Austria GmbH, dega e saj në Republikën e Kroacisë dhe nënkontraktorët e tyre, do të mbledhin dhe përpunojnë të dhënat personale të përmendura me qëllim aplikimin për realizimin e të drejtës për një dhuratë në kuadër të promovimit të subjektit.

Përdoruesi (pjesëmarrës në promovim) konfirmon gjithashtu se është njohur me Politikën e Privatësisë së Samsung, bashkangjitur këtu më poshtë, dhe se ai është i vetëdijshëm se Samsung do të trajtojë të dhënat personale të mbledhura të përdoruesit (pjesëmarrës në promovim) në përputhje me parashikimet e Politikës së Privatësisë të lartpërmendur.

Duke aplikuar për pjesëmarrje në këtë promovim, pra duke dhënë të dhënat personale në përputhje me Rregullat e promovimit në fjalë, përdoruesi (pjesëmarrës në promovim në fjalë) pohon gjithashtu se është në dijeni që Samsung Electronics Austria GmbH, Podružnica Zagreb, Radnička cesta 37, Zagreb, Kroaci, është kontrolluesi i cili kryen përpunim të të dhënave personale, dhe

- në rast se blerësi vendos të mos t'i japë të dhënat personale Samsungut, ai nuk do të ketë të drejtën e një dhurate në këtë promovim,
- se kontrolluesi i sipërpërmendur i përpunimit të të dhënave personale pas kërkesës së përdoruesit, do të plotësojë, ndryshojë ose fshijë të dhënat e tij personale nëse këto të dhëna janë të paplota, të pasakta ose të vjetruara dhe nëse përpunimi i tyre nuk bëhet në përputhje me ligjin,
- se baza ligjore për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale të përdoruesit/ve është përfitimi i së drejtës për të marrë një dhuratë si pjesë e promovimit në fjalë,
- se të dhënat personale të blerësve do të ruhen ekskluzivisht deri në përfundimin e afateve për paraqitjen e ankesave të blerësve,
- se me përjashtim të Degës në Zagreb të Samsung Electronics Austria GmbH, akses në të dhënat personale të blerësve do të ketë edhe nënkontraktori i Samsung, në kuadrin e shpërndarjes së dhuratave brenda fushës së promovimit në fjalë,
- se nëse klienti beson se të dhënat e tij personale po trajtohen në mënyrë të paligjshme, klienti ka të drejtë të paraqesë një ankesë pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në çdo kohë.

Samsung Electronics Austria GmbH